



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3795/2 Prot.

Tiranë, më 13.12.2024

V E N D I M

Nr. 50 Datë 13.12 2024

**“PËR  
MIRATIMIN E SHPENZIMEVE PËR PLANIN PËR MODULET “SKI” PËR  
STUDENTËT E FSHL DHE PROGRAMIN OUTDOR “SPORTE DIMËRORE –SKI”  
PËR STUDENTËT E FVFR DHE MIRATIMIN E REGJISTRIT TË PARASHIKIMIT  
TE PROKURIMEVE PUBLIKE PER VITIN 2025 NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE  
TË TIRANËS”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 38, të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të e RSH", në statutin e UST neni 25, të Ligjit 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të vendimit të Bordit të Administrimit nr. 33 datë 07.08.2024 "Mbi Miratimin e Propozimit të Programit Buxhetor Afatmesëm për vitin 2025-2027, për Universitetin e Sporteve të Tiranës", në shkresën e FSHL nr. 3579/1 Prot, datë 27.11.2024 "Dërgohet kërkesa dhe specifikimet për realizimin e modulit "Ski", si dhe shkresën nr. 3579 prot, datë 27.11.2024 "Përcjellje informacioni lidhur me zhvillimin e modulit "Ski"", në shkresën me nr. 3685/1 prot, datë 04.12.2024, "Përcjellje e dokumentacionit mbi zhvillimin e Outdoor "Sporte Dimërore-Ski"", si dhe shkresës me nr. 3685 datë 04.12.2024 të Departamentit të Aktivitetit Fizik Rekreacionit dhe Turizmit "Mbi specifikimet teknike e detajuar për zhvillimin e modulit "Sporte dimërore" për vitin akademik 2024-2025", në Vendimin e Rektoratit nr.96, datë 06.12.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.12.2024,Relacionin e Administratorit nr 3579/3 prot, dt 06.12.2024 Bordi i Administrimit ,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë të gjitha shpenzimet për planin mësimor të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit përkatësisht për modulet "Ski" për studentët e FSHL dhe programin Outdoor "Sporte Dimërore-Ski" për studentët e FVFR.

2. Të miratojë propozimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2024, në Universitetin e Sporteve të Tiranës sipas tabelës bashkëngjitur.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek transparenca universitare.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur ÇOBANI**

**NË MUNGESË DHE ME POROSI**

Prof. Asoc. Aida BENDO



**Autoriteti Kontraktor: Universiteti i Sporteve të Tiranës**  
**Regjistri i Parashikimeve të Prokurimeve Publike viti 2025**

Nr	Llogaria	Viti	Iri/i modifikuar	Objekti i prokurimit	Kontratë, Marrëveshje kuadër	Tipi i kontratës (mall/punë/shërbim/marrëveshje kuadër)	Fondi i llogarituar	Burimi i financimit (buxheti i shtetit, ardhura, vetëfinancim, etj)	Vlera	Lloji i procedurës së prokurimit/ Mësimkontratë/Amendament kontrate për nevojat e fillim viti	CPV Kod	Koha e planifikuar për shpalljen e procedurës (muaji)	Organi që zhvillon procedurën e prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara
1	602.91	2025	I ri	Ofrimi I shërbimit moduli ski per studentet e FSHL	Kontratë	Shërbim	4,550,400	xheti i Sht	5,111,600	Tender i hapur i thjeshtuar	55110000-4, 92600000-7, 55521200-0	Gjatë vitit 2024-2025	UST
2	602.91	2025	I ri	Ofrimi i modulit sportive dimerores per studentete e FVFR	Kontratë	Shërbim	5,289,600	xheti i Sht	5,943,760	Tender i hapur i thjeshtuar	55110000-4, 92600000-7, 55521200-0	Gjatë vitit 2024-2025	UST
3	6023900	2025	I ri	Shpenzime te tjera transporti	Kontratë	Shërbim	1,000,000	xheti i Sht	1,200,000	Prokurim me vlera të vogla	60100000-9, 60140000-1, 66516100-1, 34980000-0	Gjatë vitit 2025	UST